



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/11
Datë: 07.05.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 dhe nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafi 2 nënparagrafi 2.4, të nenit 10 paragrafin 2 nënparagrafi 2.4 dhe nenit 12 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe në zbatim të nenit 89 të Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, datë 15.03.2020 për Shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik dhe në zbatim të rekomandimeve të IKSHPK-së, me qëllim të kontrollit, parandalimit dhe luftimit të përhapjes së virusit SARS-CoV-2, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2021 merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për masa të përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19

1. Shtohet një pikë e re 3A në Vendimin Nr. 01/07, të datës 18.04.2021, si në vijim:

3A. Ndalohet hyrja në Republikën e Kosovës për personat që vijnë nga India, Brazili dhe Afrika e Jugut.

3A.1 Shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët vijnë nga India, Brazili dhe Afrika e Jugut duhet të karantinohen në shtëpitë (vendin e banimit) e tyre për katërmbëdhjetë (14) ditë duke u testuar dy herë në javë.

3A.2 Pika 3A.1 nuk vlen për shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët qëndrojnë transit (më pak se 48 orë) në shtetet e përcaktuara në pikën 3A.1 të këtij vendimi.

3A.3 Diplomatët e huaj si dhe familjarët e tyre përjashtohen nga fushëveprimi i pikës 3A të këtij vendimi.


2. Udhëzohen Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si dhe Ministria e Punëve të Brendshme të marrin vendimet dhe veprimet e nevojshme në përputhje me fushat e përgjegjesisë administrative të tyre me qëllim të zbatimit të këtij Vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh situatën aktuale epidemiologjike në botë, shfaqjen e varianteve të reja të COVID-19, në Indi, Brazil dhe Afrikë të Jugut, rrezikun e bartjes së varianteve të reja nga udhëtimet prej këtyre shteteve, për parandalimin e ardhjes së varianteve të reja u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Komunave
- Inspektorateve përgjegjëse
- Policisë së Kosovës
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë